



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat e Logarive Kombëtare**

# **Llogaritë Qeveritare të Kosovës TM3 2020**



## **P a r a t h ë n i e**

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), respektivisht Departamenti i Llogarive Kombëtare ka përgatitur publikimin e Llogarive Qeveritare të Kosovës për TM3 2020. Ky botim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

ASK-ja i është mirënjohës Ministrisë së Financave – Departamenti i Thesarit, për ofrimin e të dhënave në lidhje me këtë publikim.

Komentet, propozimet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura dhe ato mund të drejtohen në adresën elektronike: [economic@rks-gov.net](mailto:economic@rks-gov.net).

Ky publikim është përgatitur nga:

Fatmir Morina - Drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare  
Edona Rexhepaj - Udhëheqëse e Divizionit të Ekonomisë joformale dhe Llogarive Qeveritare  
Fatlie Mazreku – Zyrtare e lartë e Llogarive qeveritare  
Ilir Mazrekaj – Zyrtar i lartë i Llogarive qeveritare  
Vjosa Prekazi - Zyrtare e Llogarive qeveritare

Prishtinë, Dhjetor 2020

U.d. i Kryeshefit Ekzekutiv në ASK  
Ilir.T.Berisha

## Lista e Shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
COFOG	-	Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit
ESA2010	-	Sistemi i Llogarive Evropiane (European System of Accounts)
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MF	-	Ministria e Financave
GFSM2014	-	Udhëzuesi për Statistikat e Financave Qeveritare
TKPK	-	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
:	-	Mungojnë të dhënat
_	-	Nuk aplikohet

## P ë r m b a j t j a

Faqe

1.Hyrje.....	4
2.Të Hyrat - Qeveria e Përgjithshme.....	5
Tabela 1. Të Hyrat e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA 2010.....	5
Grafiku 1. Të Hyrat e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA 2010.....	6
3.Shpenzimet – Qeveria e Përgjithshme.....	7
Tabela 2. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA 2010.....	7
Grafiku 2. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA 2010.....	8
Tabela 3. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në bazë të COFOG-ut.....	9
Grafiku 3. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në bazë të COFOG-ut.....	10

## **1. Hyrje**

Publikimi paraqet një pasqyrë të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën TM3 2020, bazuar në mbledhjen e të dhënave administrative dhe kalkulimeve të ASK-së.

Si rregull i përgjithshëm ka për qëllim pajtueshmërinë maksimale të shifrave të publikuara me standardet e ESA 2010, manualin e klasifikimit të funksioneve të qeverisë dhe manualin e FMN-së për statistikat e Financave Qeveritare.

Burimet e të dhënave janë: Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit .

## 2. Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme

Shuma e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme në TM3 2020 ishte 512.6 milion Euro.


Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, të cilat paraqesin 65.8% të totalit të të hyrave, ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori tjera të të hyrave.

**Tabela 1. Të Hyrat e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010**

(në milion Euro)												
ESA2010	Përshkrimi	TM1_2018	TM2_2018	TM3_2018	TM4_2018	TM1_2019	TM2_2019	TM3_2019	TM4_2019	TM1_2020	TM2_2020	TM3_2020
D21	Tatimet në produkte	258.7	335.0	394.3	353.3	287.2	347.3	405.8	378.7	295.5	278.5	337.1
D211	Tatimi mbi vlerën e shtuar(TVSH)	149.3	188.9	217.3	203.4	163.5	196.0	227.4	218.9	171.5	157.1	194.4
D212	Tatimi dhe dogana ne importe duke perjashtuar TVSH	100.8	137.1	167.1	140.7	114.9	140.0	167.5	150.0	116.0	114.8	132.8
D2121	Detyrimet e importit	24.9	32.3	34.6	38.4	27.3	35.2	37.9	36.9	25.3	21.9	28.1
D2122	Taksat për importet pa TVSH dhe detyrimet	75.9	104.9	132.5	102.2	87.6	104.8	129.7	113.1	90.7	93.0	104.7
D214	Tatimi mbi produktet, me përjashtim të TVSH-së dhe tatimet e importit	8.5	9.0	10.1	9.3	8.8	11.3	10.9	9.8	8.0	6.6	9.9
D29	Tatimet tjera në prodhim	10.0	10.1	10.1	9.8	10.8	11.8	12.5	10.9	11.3	9.8	13.3
D4	Të hyrat nga prona	-	6.5	-	6.5	-	6.7	0.0	6.9	-	7.2	0.0
D5	Tatimet rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj.	70.7	68.7	62.4	69.7	63.3	75.4	71.6	70.6	63.9	60.0	68.9
D7	Transferrat e tjera aktuale	4.4	6.3	7.2	7.9	7.3	5.2	6.1	19.9	5.7	6.0	15.5
F	Aktivitet dhe detyrimet financiare	39.0	11.9	133.8	23.4	72.8	138.5	72.8	25.5	2.8	213.8	57.5
P131	Pagesat për output jo-tregut (Shitjet)	25.8	22.4	28.1	30.1	23.4	25.9	31.9	32.2	23.3	11.9	20.3
<b>Gjithsej</b>		<b>408.5</b>	<b>461.0</b>	<b>635.9</b>	<b>500.7</b>	<b>464.8</b>	<b>610.8</b>	<b>600.7</b>	<b>544.6</b>	<b>402.4</b>	<b>587.2</b>	<b>512.6</b>

Struktura e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 1.

**Grafiku 1. Të Hyrat e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010**



### 3. Shpenzimet – Qeveria e Përgjithshme

Shuma e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme në TM3 2020 ishte 579.8 milion Euro.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë kontributet sociale dhe përfitimet me 30.9%, kompensimi i punëtorëve 28.3%, formimi i kapitalit bruto 16.3%, konsumi i ndërmjetëm 9.0%, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategori tjera të shpenzimeve.


**Tabela 2. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010**

												(në milion Euro)
ESA2010	Përshkrimi	TM1_2018	TM2_2018	TM3_2018	TM4_2018	TM1_2019	TM2_2019	TM3_2019	TM4_2019	TM1_2020	TM2_2020	TM3_2020
D1	Kompensimi i punëtorëve	143.8	149.7	145.6	152.8	149.7	155.7	152.3	159.9	154.7	172.1	164.0
D3	Subvencionet	19.8	16.4	36.8	34.7	19.8	29.0	19.8	48.9	16.7	24.2	25.8
D4	Të ardhurat nga prona, të pagueshme	6.0	3.3	6.1	3.4	7.3	3.9	13.5	(1.6)	9.1	4.4	8.4
D6	Kontributet sociale dhe përfitimet	111.3	117.0	120.0	133.4	120.3	131.1	132.1	146.5	133.0	187.8	179.1
D7	Transferrat e tjera aktuale	7.8	6.4	7.0	8.4	5.1	8.9	6.6	8.2	4.0	7.6	9.0
D9	Transferrat kapitale	2.7	1.8	2.6	13.5	3.3	10.6	6.0	6.7	0.9	5.7	7.2
F	Aktivitet dhe detyrimet financiare	5.8	3.3	6.4	7.4	10.4	13.3	12.5	20.0	15.4	25.3	27.1
NP	Posedimi i aktiveve jo-prodhuese	0.4	1.1	1.1	4.0	0.1	1.2	4.2	10.9	1.2	1.6	12.5
P2	Konsumi i ndërmjetëm	40.8	46.8	43.8	78.0	45.4	53.1	59.3	92.3	40.3	47.2	52.4
P5	Formimi i kapitalit bruto	74.9	95.8	105.2	212.8	39.7	87.3	105.6	252.8	25.0	59.1	94.4
<b>Gjithsej</b>		<b>413.5</b>	<b>441.8</b>	<b>474.5</b>	<b>648.2</b>	<b>401.0</b>	<b>493.9</b>	<b>511.9</b>	<b>744.8</b>	<b>400.3</b>	<b>534.9</b>	<b>579.8</b>



Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 2.

### Grafiku 2. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010



Në bazë të COFOG-ut shuma e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme në TM3 2020 ishte 579.8 milion Euro.

Shpërndarja më e madhe e shpenzimeve është bërë në sektorin: mbrojtja sociale 23.0%, çështjet ekonomike 19.5%, shërbime të përgjithshme 17.1%, arsimi 13.2%, shëndetësia 10.8% ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në sektorët e tjerë.


**Tabela 3. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në bazë të COFOG-ut**

(në milion Euro)

Përshkrimi	TM1_2018	TM2_2018	TM3_2018	TM4_2018	TM1_2019	TM2_2019	TM3_2019	TM4_2019	TM1_2020	TM2_2020	TM3_2020
Shërbimet e përgjithshme	48.0	52.6	59.7	85.2	62.5	75.5	80.4	118.2	58.7	81.3	99.2
Mbrojtja	8.4	9.9	8.3	20.0	6.3	7.5	9.7	26.5	8.4	12.3	18.3
Rendi dhe siguria publike	37.7	43.9	41.2	53.6	41.5	48.4	43.0	64.8	42.6	58.1	48.5
Çështjet Ekonomike	87.6	87.0	107.9	168.3	52.0	91.3	81.8	179.5	46.9	87.7	113.0
Mbrojtja e Mjedisit	0.8	2.9	6.2	6.5	0.5	3.5	6.6	13.0	0.3	2.3	5.4
Strehim dhe pajisje për Komunitetin	4.8	7.9	8.2	22.4	2.9	9.2	12.7	19.0	2.8	7.1	9.7
Shëndetësia	42.1	45.6	47.2	64.8	40.6	51.1	52.9	76.2	43.1	59.5	62.7
Rekreacioni, kultura dhe Religjioni	12.9	10.5	16.0	17.7	13.5	12.8	17.9	16.8	7.9	10.3	12.8
Arsimi	64.4	70.7	69.3	97.5	63.1	74.7	84.4	100.9	62.7	69.7	76.8
Mbrojtja sociale	106.8	110.9	110.7	112.1	118.2	120.0	122.6	129.9	126.9	146.7	133.5
<b>Gjithsej</b>	<b>413.5</b>	<b>441.8</b>	<b>474.5</b>	<b>648.2</b>	<b>401.0</b>	<b>493.9</b>	<b>511.9</b>	<b>744.8</b>	<b>400.3</b>	<b>534.9</b>	<b>579.8</b>

Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 3.

**Grafiku 3. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në bazë të COFOG-ut**



# Agjencia e statistikave të Kosovës

*përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Në kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale;*** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>